

LIGJ
Nr. 42/2021

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 97/2016, “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:
“dh) “Këshilltar ligjor” është këshilltari që ushtron funksionin e tij në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme.”.

Neni 2

Në nenin 15, pika 1, pas togfjalëshit “krimit të organizuar” shtohet fjala “,terrorizmit”.

Neni 3

Në nenin 57, pika 1, shkronja “a”, pas termit “kancelari” shtohet togfjalëshi “, këshilltari ligjor”.

Neni 4

Në nenin 65, pika 1, togfjalëshi “prokurorët e komanduar, sipas nenit 69 të këtij ligji” zëvendësohet me togfjalëshin “Njësia e Shërbimit Ligjor”.

Neni 5

Neni 69 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 69

Njësia e Shërbimit Ligjor

1. Pranë Prokurorisë së Përgjithshme funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor.
2. Ajo ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Prokurorisë së Përgjithshme duke përfshirë:
 - a) analizimin, studimin e ankimeve dhe dosjeve penale;
 - b) përgatitjen e relacioneve për çështjet objekt gjykimi përpara Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese;
 - c) kryerjen e kërkimeve ligjore;

c) përgatitjen e projektakteve;
d) kryerjen e detyrave të tjera për përpunimin e çështjeve që i ngarkohen nga Prokurori i Përgjithshëm.

3. Njësia e Shërbimit Ligjor është në varësi të Prokurorit të Përgjithshëm, i cili cakton këshilltarin ligjor pranë një prokurori ose drejtorie në Prokurorinë e Përgjithshme, duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe specializimin e tyre, si dhe duke siguruar ngarkesë pune të barabartë ndërmjet tyre.

4. Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarët ligjorë, në të cilën më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm përbëhet nga ndihmësmagjistratë të komanduar, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

5. Prokurorët e komanduar caktohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në Prokurorinë e Përgjithshme sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Statusi i prokurorëve të komanduar përcaktohet në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

6. Vlerësimi i punës së prokurorëve të komanduar kryhet nga drejtuesi i prokurorisë, bazuar në mendimin e dhënë nga prokurori pranë të cilit është komanduar.

7. Këshilltarët ligjorë jomagjistratë emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj. Këshilltari ligjor jomagjistratë përfiton pagë të barabartë me “pagën bruto fillestare” të prokurorit pranë gjykatës së shkallës së parë, pa përfitimet e tjera financiare, sipas referimeve të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

8. Këshilltari ligjor jomagjistratë duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë diplomuar në drejtësi në nivelin “Master shkencor”, të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;

b) përvojë profesionale jo më pak se 5 vjet si nëpunës i lartë në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose në organizatat ndërkombëtare;

c) njohuri në jurisprudencën e gjykatave vendase dhe atyre ndërkombëtare;

ç) njohuri shumë të mira të paktën të një gjuhe të vendeve të Bashkimit Europian;

d) aftësi të shkrimit dhe arsyetimit ligjor;

dh) të mos ketë masa disiplinore në fuqi në pozicionet e mëparshme;

9. Këshilltari ligjor dhe ndihmësmagjistrati u nënshtrohen rregullave të papajtueshmërisë, kufizimeve në detyrë dhe konfliktit të interesave ashtu si magjistrati.

10. Prokurori i Përgjithshëm përfshin në projektbuxhet propozimin për numrin e këshilltarëve ligjorë.

11. Prokurori i Përgjithshëm miraton rregulla të detajuara për numrin e këshilltarëve ligjorë dhe funksionimin e Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Neni 6

Në nenin 70, pika 1, pas shkronjës “a” shtohet shkronja “a/1” me këtë përmbajtje:
“a/1) këshilltari ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme;”.

Neni 7

Në nenin 72 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, pas togfjalëshit “kryen formimin fillestar dhe vazhdues të kancelarëve” shtohet togfjalëshi “dhe këshilltarëve ligjorë në Prokurorinë e Përgjithshme” dhe pas togfjalëshit “për një periudhë prej të paktën tre muajsh” shtohet togfjalëshi “dhe për këshilltarët ligjorë për një periudhë prej të paktën nëntë muajsh”.

2. Në pikën 4, pas togfjalëshit “për kancelarët” shtohet togfjalëshi “dhe këshilltarët ligjorë”.

Neni 8

Në nenin 73 bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e dispozitës, pas togfjalëshit “për kancelar” shtohet togfjalëshi “dhe këshilltarë ligjorë”.
2. Në pikën 1 pas togfjalëshit “të paktën çdo tre vjet” shtohet togfjalëshi “dhe për këshilltarët ligjorë”.
3. Në pikën 2 pas togfjalëshit “numrin e vendeve të lira” shtohet togfjalëshi “për këshilltarët ligjorë për vitin e ardhshëm”.

Neni 9

Në nenin 75, pika 1, pas togfjalëshit “për kancelarët” shtohet togfjalëshi “dhe këshilltarët ligjorë”.

Neni 10

Në nenin 76 pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Për pozicionin e këshilltarit ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, kandidatët duhet të përmbushin kriteret e parashikuara në nenin 69 të këtij ligji.”.

Neni 11

Në nenin 78, pika 2, pas togfjalëshit “renditjen e kancelarëve” shtohet togfjalëshi “dhe këshilltarë ligjorë”.

Neni 12

Në nenin 79 bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e dispozitës, pas togfjalëshit “kancelarit” shtohet togfjalëshi “dhe këshilltarit ligjor”.
2. Në pikën 1 pas fjalës “kancelarit” shtohet togfjalëshi “dhe këshilltarit ligjor”.
3. Në pikën 2 pas togfjalëshit “për kancelar” shtohet togfjalëshi “dhe këshilltar ligjor” dhe pas togfjalëshit “për pozicionin e kancelarit” shtohet togfjalëshi “dhe këshilltarit ligjor”.
4. Në pikën 3 pas togfjalëshit “për kancelar” shtohet togfjalëshi “dhe për këshilltar ligjor”.

Neni 13

Në nenin 84 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3 pas togfjalëshit “për emërimin e kancelarëve” shtohet togfjalëshi “,këshilltarëve ligjorë jomagjistratë”.
2. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me përmbajtjen si më poshtë:
“5/1. Këshilltari ligjor kandidat merr një shpërblim të barabartë me 50 për qind të pagës fillestare si këshilltar ligjor gjatë kursit të formimit fillestar.”.
3. Në pikën 6, fjalia e parë, pas fjalës “Kancelarët” shtohet togfjalëshi “dhe këshilltarët ligjorë” dhe në fjalinë e dytë pas togfjalëshit “mandati i kancelarit” shtohet togfjalëshi “ose këshilltarit ligjor”.
4. Pika 8 shfuqizohet.

Neni 14

Në nenin 86, pika 3, fjalia e tretë, pas termit “kancelarit” shtohet togfjalëshi “dhe këshilltarit ligjor”.

Neni 15

Në nenin 87, pika 2, pas togfjalëshit “për kancelarin” shtohet togfjalëshi “dhe këshilltarin ligjor”.

Neni 16

Në nenin 89 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja “a”, pas togfjalëshit “përveç kancelarit” shtohet togfjalëshi “dhe këshilltarit ligjor”.
2. Në pikën 1, shkronja “b”, pas togfjalëshit “për kancelarin” shtohet togfjalëshi “dhe këshilltarin ligjor”.
3. Në pikën 2, shkronja “a”, pas togfjalëshit “për kancelarin” shtohet togfjalëshi “dhe këshilltarin ligjor”.

Neni 17

Në nenin 100, pika 3, pas togfjalëshit “për kancelarin” shtohet togfjalëshi “dhe këshilltarin ligjor”.

Neni 18

Pas nenit 108 shtohet neni 108/a me këtë përmbajtje:

“Neni 108/a

1. Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë të drejtë të kenë akses të drejtpërdrejtë, si subjekte të interesuara, në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore, që përmbajnë informacionin e nevojshëm për hetimin e veprave penale që përfshihen në juridiksionin e tyre sipas nenit 148 të Kushtetutës.

2. Niveli i aksesimit për prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, për çdo bazë të dhënash shtetërore, caktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon bazat e të dhënave shtetërore, duke garantuar që në çdo rast ky nivel të jetë vetëm për përmbushjen e nevojës për informacion që kërkohet nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Prokurorët mund të aksesojnë një bazë të dhënash shtetërore vetëm në rastet kur informacioni që ruhet në atë bazë të dhënash shtetërore është i nevojshëm për të hetuar një vepër penale.

3. Aksesit në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore, sipas këtij neni, u nënshtrohet rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi. Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, si dhe institucionet shtetërore që administrojnë bazat e të dhënave shtetërore marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme ose aksidentale, si dhe nga humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Parashikimet e bëra në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave që ruajnë dhe/ose përpunojnë informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”. Aksesit i prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm në sistemet e informacionit apo

bazat e të dhënave duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror.”.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 23.3.2021.